



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME**

Data/Datum/Date:	17/11/2023
Nr./Br./No	04/39
Për/Za/To:	Zyra e Kuvendit, Komiteti për Politikë dhe Financa
Përmes/Preko/Through:	Drejtorja për Zhvillim Ekonomik
Nga/Od/From:	Kastriot Shabani, Drejtor për Zhvillim Ekonomik
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim për diskutim publikë



Të nderuar/a


Më lejoni që përmes kësaj shkrese ju njoftoj për raportimin bazuar në ligjin Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-40 neni 58 në mbledhjen e radhës së Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin Komunal të Shtimes.

Propozim për diskutim publikë, Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024/2027.




REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Shtime



KOMUNA SHTIME
MUNICIPALITY OF SHTIME

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2024- 2027



Shtime, Shtator 2023

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	5
2. HYRJA	6
3. METODOLOGJIA	7
4. VIZIONI, MISIONI, QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIM EKONOMIK	10
5. SFONDI.....	10
5.1 ANALIZA E GJENDJES AKTUALE	10
5.1.1 POZITA DHE VEÇORITË GJEOGRAFIKE	11
5.1.2 HISTORIKU I KOMUNËS SË E SHTIMES	12
5.1.3 KUSHTET KLIMATIKE DHE RELIEVI	12
5.1.4 PEDOLOGJIA DHE GJEOLGJIA	13
5.1.5 PASURITË NATYRORE	14
5.1.6 NUMRI I POPULLSISË	15
5.1.7 ARSIMI	17
5.1.8 KULTURA DHE SPORT	18
5.1.9 SHËNDETI PUBLIK DHE MIRËQENJA SOCIALE.....	20
5.1.10 INFRASTRUKTURA FIZIKE	21
5.1.11 TRANSPORTI.....	22
5.1.12 EKONOMIA	23
5.1.12.1 STRUKTURA EKONOMIKE	24
5.1.12.2 ZONAT EKONOMIKE - PARKU TEKNOLOGJIK NË SHTIME 1, PARKU TEKNOLOGJIK NË GLLAVICË DHE PARKU TEKNOLOGJIK DAVIDOVÇ	25
5.1.13 BUJQËSIA	26
5.1.14 TURIZIMI	28
5.1.15 SEKTORI MINERAR	29
5.1.16 MJEDISI (RESURSET UJORE DHE MENAXHIMI I TYRE)	30
5.1.17 AJRI DHE ZHURMA.....	32
5.1.18 MENAXHIMI MBETURINAVE	32
5.2 Përkufizimi i problemit.....	34
6. QEVERISJA KOMUNALE	35
6.1 STRUKTURA DHE ORGANOGAMI I ADMINISTRATËS KOMUNALE	36
6.2 STRUKTURA DHE PËRBËRJA E KOMISIONEVE TË KUVENDIT KOMUNAL	37
6.3 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET KOMUNALE, PARA HARTIMIT TË SZHEL-SË.....	37
7. ANALIZA E PROBLEMIT DHE MUNDËSIVE PËR ZGJIDHJE	38
7.1 VLERËSIMI I AFTËSIVE KONKURRUESE (SWOT)	38
7.2 PËRMBLEDHJA E SFIDAVE.....	40
8. OBJEKTIVAT.....	41
8.1 OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIK, AKTIVITETET DHE PROJEKTET	41
8.2 PLANI VEPRIMIT 2024 - 2026	48
9.MONITORIMI DHE RAPORTIMI (MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË	55

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

9.1 NDIKIMI BUXHETOR (NDIKIMI FINANCIAR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË)	55
--	----

Përmbajtja e Tabelave

Tabela 1 – të dhëna të përgjithshme statistikore të komunës së Shtimes	12
Tabela 2: Tipet e tokave kryesore në komunën e Shtimes.....	13
Tabela 4 - Struktura e popullsisë sipas moshës	16
Tabela 5. Strukturën e përkatësisë etnike	16
Tabela 6 – të dhënat statistikore të institucioneve arsimore	17
Tabela 7 – Objektet e trashëgimisë kulturore	18
Tabela 8 - Investimeve në infrastrukturë e shprehur në njësi matëse (km, m ²)	21
Tabela 9 – struktura e bizneseve dhe pronësia sipas gjinisë.....	24
Tabela 10: Sipërfaqet e kulturave bujqësore sipas llojeve.....	27
Tabela 11 - Vlerësimet e hershme buxhetore 2024-2026	37
Tabela 12 Projektionet e shpenzimeve buxhetore Komunale	37
Tabela 13 - Buxhetit i planifikuar për vitin 2024	38

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

SZHEL	Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal
NVM	Ndërrmarjet e vogla, të mesme
SWOT	Strengths, Weaknesses, Opportunity and Threats
SVL	Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale
PLVM	Plani lokal i veprimit në mjedis
PZHK	Plani i Zhvillimit Komunal
KASH	Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve
KM	Kilometër
IEAA	Institucione edukativo-arsimore dhe aftësuese
OJQ	Organizata joqeveritare
UÇK	Ushtria Çlirimtare të Kosovës
QKMF	Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare
QMF	Qendrës Mjekësisë Familjare
QPS	Qendrës për Punë Sociale
MPMS	Ministritë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale
(IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosoves
AMMK)	Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
KRU	Kompanitë Regjionale të Ujësjetllësit
IKSHPK	Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik
PM	Madhesia grimcave
KRM	Kompania rajonale e mbeturinave
GQ	Grantet qeveria
THV	Të hyrat vetanake
P	Projekti
BE	Bashkimi Evropian
DZHE	Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik
DPUKGJ	Drejtorja për PPlanifikim, Katastër, Urbanizëm dhe Gjeodezi
DRKS	Drejtorja për Rini, Kulturë dhe Sport
DSHMS	Drejtorja për Shëndësi, dhe Mirëqenje Sociale

Falënderim

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal në komunën e Shtimes 2023 - 2025, është përgatitur nga anëtarët e Grupit Punues të komunës së Shtimës, në bashkëpunim dhe mbështetje nga kompania konsulente “SWOT Consulting” e cila ka angazhuar ekspertin Basri Hysenin. Komuna e Shtimes shpreh falënderim për kompaninë konsulente e përmendur më lartë për mbështetjen dhe kontributin e dhënë në hartimin e kësaj Strategjie.

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Strategjia Zhvillimit Ekonomik Lokal në komunën e Shtimes përcakton zhvillimin e qëndrueshëm si një proces i orientuar drejt qëllimit, afatgjatë, të vazhdueshëm, gjithëpërfshirës dhe sinergjik që prek të gjitha aspektet e jetës (ekonomike, sociale, mjedisore dhe institucionale) për të gjithë nivelet brenda komunës së Shtimes. Zhvillimi i qëndrueshëm nënkupton krijimin e një modeli që në mënyrë cilësore plotësojnë nevojat dhe interesat socio-ekonomike të qytetarëve dhe në të njëjtën kohë largojnë ose reduktojnë ndjeshëm ndikimet që kërcënojnë ose dëmtojnë mjedisin dhe burimet natyrore.

Koncepti afatgjatë i zhvillimit të qëndrueshëm të komunës së Shtimes nënkupton rritje të vazhdueshme ekonomike e cila, përveç efikasitetit ekonomik, progresi teknologjik, teknologjitë menqura kundrejt ambientit (marrë parasysh ndryshimet klimatike), inovacionin në gjithë shoqërinë dhe biznesi me përgjegjësi shoqërore, siguron uljen e varfërisë, përdorimi më i mirë afatgjatë i burimeve, përmirësimi i kushteve shëndetësore dhe cilësisë së jetës dhe uljen e ndotjes në një nivel që mund të përballojnë faktorët mjedisorë, parandalimi ndotjes së re dhe ruajtja e biodiversitetit. Një nga qëllimet më të rëndësishme të zhvillimit të qëndrueshëm është hapja e vendeve të reja të punës dhe ulja e shkallës së papunësisë, si dhe ulja pabarazitë gjinore dhe sociale të grupeve të marginalizuara, duke nxitur punësimin të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe grupet e tjera të rrezikut.

Lista e Objektivave Përgjithshme të Strategjisë (Vetëm objektivat e përgjithshme duhet të listohen këtu).

Objektivi përgjithshëm 1: Të krijohet një klimë e favorshme për zhvillimin e biznesit

Objektivi përgjithshëm 2: Të përmirësohet cilësia e shërbimeve publike dhe infrastrukturës

Objektivi përgjithshëm 3: Të zhvillohet turizmi rural

Objektivi përgjithshëm 4: Të promovohet zhvillimi bujqësisë intenzive

Objektivi përgjithshëm 5: Të krijohet një mjedis i favorshëm socio-kulturor, arsimor dhe ekologjik

Një përmbledhje e rekomandimeve për të adresuar dhe kompletuar objektivat e përgjithshme që janë listuar më lartë se ende mungon infrastruktura ligjore, infrastruktura fizike, mungesa e studimeve të fizibilitetit në lidhje me shfrytëzimin e resurseve natyrore, digjitalizimi shkollave dhe institucioneve publike, menaxhimi mbeturinave me theks të veçant atë inerte, investime në objektet e trashëgimisë kulturore, muzetë, terrent sportive etj.

Rekomandimet kryesore për secilin sektorë:

Klimë e favorshme për zhvillimin e biznesit - mungon infrastruktura ligjore, infrastruktura fizike, lejet e nevojshme për operimin e këtij parku teknologjik në nivelin qendror dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike për zonat tjera industriale, parku teknologjik në Shtime dhe zona biznesore në Davidovc. Po ashtu promovimi shfrytëzimit të burimeve natyrore - nëpërmes studimeve të ndryshme të fizibilitetit në lidhje me

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

resurset natyrore, mundësit e zhvillimit në bujqësi, në resurset energjetike ripërtëritëse etj.

Përmirësimi cilësisë së shërbimeve publike dhe infrastrukturës - Infrastruktura publike ende nuk është e kompletuar duke filluar nga rrugët lokale, ndriqimi, menaxhimi mbeturinave.

Zhvillimi i turizmit rural - ka nevojë për studime dhe investime, duke i dhënë prioritet këtij sektori dhe mundësit që ofron komuna Shtimes

Promovimi i zhvillimit të bujqësisë intenzive – marr parasysh se është trend global dhe historik është krijimi i fermave të mëdha dhe intenzive atëherë fokusi i investimit duhet të jetë mbështetja financiare.

Mjedis i favorshëm socio-kulturor, arsimor dhe ekologjik – ku përfshihen renovimi shkollave egzistuese dhe digjitalizimi në shkollë, vlerësimi i hapësirës shkollore para se të vendose për ndërtim, të ndonjë shkolle, sa i përket menaxhimit të mbeturinave veqanërisht problem në vehte mbetet mbeturinat inerte.

2. HYRJA

Marrë parasysh orientimet strategjike zhvillimore, Komuna e Shtimes do të bëjnë përpjekje që përmes zhvillimit ekonomik lokal të përmirësojnë dhe ngritin kualitetin e jetës së qytetarëve duke krijuar mundësi të reja në mirëqenien ekonomike dhe shoqërore. Kjo strategji trajton aspektet e zhvillimit ekonomik lokal të orientuara në drejtim të partneritetit me të gjitha palët e interesit me qëllim të rritjes së punësimit, uljes së nivelit të varfërisë dhe rritjes së cilësisë së jetesës.

Zhvillimi ekonomik mund të arrihet vetëm kur komuna e Shtimes tregon qeverisje më të mirë dhe ofrojnë shërbime të nevojshme për publikun nëpërmjet përmirësimit dhe avancimit të vetëqeverisjes lokale në fushën e ekonomisë. Për të arritur këto qëllime, komunat fokus të veçantë duhet ti japin përmirësimit dhe zhvillimit të infrastrukturës lokale, krijimit të kushteve të përshtatshme për zhvillimin, promovimin e bizneseve të vogla dhe të mesme lokale, zhvillimi i sektorit të bujqësisë, nxitjen e krijimit të vendeve të reja punës përmes investimeve të reja qoftë nga vendi, e po ashtu edhe nga jashtë.

Zhvillimi i kësaj strategjie ndërlidhet me një sërë dokumentesh strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të komunës dhe burime tjera sekondare të informatave, strategji të zhvillimit ekonomik lokal të komunave të ndryshme në Kosovë që në shumicën e sektorëve gjasojnë me komunën e Shtimes, si:

- Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026;
- Plani lokal i veprimt në mjedis në komunën e Shtimes 2021-2025
- Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Shtimes 2023-2027
- Draft Plani i Zhvillimit Komunal në komunën e Shtimes 2019 – 2027
- Organogrami i Komunes dhe Drejtorive në komunën e Shtimes
- Strategjia e komunës së Klinës 2023 – 2028
- Strategjia e komunës së Rahovecit 2021 – 2025
- Plani për menaxhimin e tokave rurale në komunën e Shtimes 2023–2027
- Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve në komunën e Shtimes 2024-2027
- Strategjia-e-zhvillimit-ekonomik-publik në komunën e Shtimes 2019-2022

3. METODOLOGJIA

Hartimi i këtij dokumenti të rëndësishëm zhvillimor ka kaluar nëpër një proces gjithëpërfshirës të pjesëmarrjes së shumë akterëve dhe ka kaluar nëpër disa faza:

- Ndërlidhja me dokumentet strategjike siq u listuan më lartë
- Antarët e grupit punues përfaqësuar nga drejtorët e drejtorive përkatëse të komunës dhe anëtarëve të tjerë pjesë të grupit punues
- Pjesëmarrësit në punëtorin e organizuar me gjithë aktorët relevant të zhvillimit në komunën e Shtimes, me qëllim që të shfrytëzohet teknika “brainstorming” në lidhje me definimin e objektivave të përgjithshme, specifike, aktivitete dhe projektet dhe analiza SWOT.
- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave mbi gjendjen ekzistuese në komunë
- Analiza e aftësisë konkurruese të komunës (analiza SWOT)
- Definimi i Vizionit, Misionit, Synimeve, Objektivave, programeve dhe projekteve konkrete

Në fillim të procesit për hartimin e Strategjisë komunale u formua Grupi punues për hartimin e SZHEL, dhe Grupet e Palëve të Interesuara nga ana e kryetarit të komunës zotit Dr. Qemajl Aliu.

Ekipit SZHEL dhe Grupeve Punuese u është dhënë mbështetje e plotë politike nga udhëheqja komunale me drejtoritë përkatëse dhe se kompania konsultuese ka pasur qasje në të gjitha dokumentet dhe informatat e komunës.

Në fazën e parë pas periudhës së tenderimit është vendosur në bazë të vlerësimit të dosjes së prokurimit që si hartues i kësaj Strategjie të zgjedhet kompania konsultuese – “SWOT consulting” e cila pastaj ka angazhuar dhe kontraktuar ekspertin për hartimin e strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal – Basri Hyseni. Pas mbylljes dhe nënshkrimit të kontratës në mes Autoritetit Kontraktues dhe Kompanisë përfituese të tenderit Kryetari i Komunës ka caktuar grupin punues nga stafi menaxherial i komunës dhe sektori privat.

Grupin Punues për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal, është i përbërë nga 9 anëtarë:

1. Kastriot Shabani, (udhëheqës i grupi punues), drejtor për Zhvillim Ekonomik
2. Grejtalb Emiri, drejtor për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi
3. Jeton Raka – drejtor i Prokurimit
4. Bardhyl Rushiti, drejtor për Shërbime Publike
5. Albana Fazliu, drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport
6. Yllka Fejzullahu, drejtor për Arsim
7. Gonxhe Osmani – drejtoreshë Inovacionit
8. Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar
9. Rexhep Limani, drejtor shoqatës së biznes

Grupi punues i kryesuar nga Kastriot Shabani (udhëheqës i grupi punues), është takuar me datën 11 Shtator 2023 së bashku me kompaninë konsultuese një takim konsultativ ku janë ndarë detyrat me antarët e grupit me qëllim që të ndihmohet, koordinohen aktivitetet

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

etj. Është vendosur se puntoria e parë të mbahen në resortin “Hija Maleve” Jezerc me datën 21 Shtator 2023, ku në takim do të jenë grupi punues dhe palët e interesit. Me datën 21 Shtator 2023 është mbajtur punësoria e cekur më lartë ku kanë qenë 21 pjesëmarrës.

Lista e pjesëmarrësve në punëtorinë - Hartimi i strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal 2024 – 2027			
Nr.	Emri&mbiemri	Pozita	Insitucioni
1	Kastriot Shabani	Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Bujqësisë	Publik
2	Grejtalb Emini	Drejtor në Drejtorinë për Planifikimit Urban, Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë	Publik
3	Gojart Bajrami	Zyrtar në Drejtorisë së Administratës Publike	Publik
4	Feride Rexhaj	Zyrtare në Drejtorinë e Prokurimit	Publik
5	Ejup Ismajli	Shef ne Drejtorinë së Zhvillimit Ekonomik dhe Bujqësisë	Publik
6	Valon Jonuzi	Drejtor i Drejtorisë së Administratës Publike	Publik
7	Imer Tershana	Antar i Klubit Biznesit Shtime	Shoqëria civile
8	Adriatik Beqa	Antar i Klubit Biznesit Shtime	Shoqëria civile
9	Rexhep Limani	Pronar i Agrocoop	Shoqëria civile
10	Gazmend Hysenaj	Zyrtar në Drejtorinë për Planifikimit Urban, Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë	Publik
11	Bardhyl Rushiti	Drejtor Shërbime Publike	Publik
12	Vesa Zeqiri	Zyrtare ne Drejtorinë së Zhvillimit Ekonomik dhe Bujqësisë	Publik
13	Tafil Hasani	Zyrtar në Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Bujqësisë	Publik
14	Faruk Beqa	Nënkryetar I komunës	Publik
15	Bashkim Ahmeti	Zyrtar ne Drejtorinë së Zhvillimit Ekonomik dhe Bujqësisë	Publik
16	Ramadan Ukaj	Zyrtar në Drejtorinë për Planifikimit Urban, Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë	Publik
17	Safet Brahimi	Zyrtar ne Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Bujqësisë	Publik
18	Yllka Fejzullahu	Drejtoreshë në Drejtorinë e Arsimit	Publik
19	Albana Fazliu	Drejtoreshë në Drejtorinë e kulturës, rinisë dhe sportit	Publik
20	Gonxhe Osmani	Drejtoreshë në Drejtorinë e Inovacionit	Publik
21	Tringa Rushiti	Zyrtare në Drejtorinë e Arsimit	Publik

Ekipi për hartimin e SZHEL së bashku me grupet punuese vazhdoi punën në grumbullimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave për lëvizjet demografike, punësimin, arsimin, NVM-të, bizneset dhe strukturën e tyre, investimet, infrastrukturën dhe në bazë të të dhënave të mbledhura ka arritur në vlerësimin e aftësisë konkurruese sipas teknikës SWOT.

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

Në vazhdim ekipi i SZHEL, në bashkëpunim me aktetë tjerë komunalë, kanë bërë edhe definimin e vizionit, misionit, synimeve dhe objektivave për periudhën e ardhshme katërvjeçare, të cilat mund të realizohen vetëm në bazë të programeve dhe projekteve të identifikuara në këtë strategji. Puna e përbashkët e ekipit është prezantuar edhe para aktetëve të interesit të përfaqësuar nga përfaqësuesit e institucioneve publike, organizatave civile, organizatave private profesionale, grupeve të ekspertëve si dhe komunitetit të biznesit. Rishikimi dokumenteve, strategjive paraprake në komunën e Shtimes dhe rishqyrtimi dhe krahasimi me strategji të njëjta në nivel vendi me dy komuna: Rahovecit dhe Klinës, pra me komuna që përfaqësojnë komuna Shtimes ka kapacitete të njëjta zhvillimore, demografike, ambientale, etj.

Mledhja e dytë e grupit punues është mbajtur me datën 25 Shtator dhe ka pasur si qëllim kryesor me grupin punues dhe palët e interesit prezantimin i draftit fillestar për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024-2027, i cili pas aprovimit nga Grupi punues është dërguar në Kuvendin Komunal për aprovim me qëllim që ky dokument strategjik me publikuar për diskutim publik, në afat prej 30 ditësh.

Kryesuesit e grupeve punuese kanë vendosur kontakte me zyrtarët e Qeverisë së Kosovës dhe të institucioneve tjera, në mënyrë që të harmonizohen interesat e përbashkëta për prioritetet e projekteve zhvillimore të komunës në përputhje me prioritetet e nivelit qendror, këto kontakte janë me Ministrinë e Financave për projektin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2025, me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë projekti për Zona Ekonomike, me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për projektin e Shërbimeve Këshillimore, me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për projektin Hartave Zonale, si dhe kontaktet me institucione tjera.

Për më shumë në lidhje me renditjen e aktiviteteve shih listimin e hapave për hartimin dhe përfundimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal (SZHEL):

Aktiviteti	Përshkrimi
HAPI 1: Formimi I grupit punues	➤ Përcaktimi i përbërjes së grupit punues duke përfshirë Kryesuesin e grupit, anëtarët nga departamente relevante të Komunës dhe aktetë të ndryshme.
HAPI 2: Takimi Publik	➤ Diskutim i hapur me palët të interesuara duke përfshirë qytetarët para hartimit të Strategjisë ku çështjet të rëndësishme që duhet të jenë pjesë të Strategjisë janë përcaktuar.
HAPI 3: Analiza	➤ Përgatitja e pjesëve përkatëse; ➤ Mbledhja e të dhënave; ➤ Diskutimet me grupin punues; ➤ Konsultimet me palë të ndryshme; ➤ Analiza e të dhënave të mbledhura; ➤ Identifikimi i hapave të ardhshme;
HAPI 4: Konsultimi	➤ Konsultimi i draftit të Strategjisë përmes uebfaqës së Komunës dhe me takime publike me qytetarë.

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

HAPI 5: Analiza pas-konsultimit	➤ Analiza e komenteve/sugjerimeve nga konsultimet me publikun ➤ Përfshirja/mos përfshirja e komenteve në draftin përfundimtar të Strategjisë ➤ Raporti i konsultimeve
HAPI 6: Takimi I fundit të Grupit Punues	➤ Finalizimi i Strategjisë dhe dërgimi e saj për aprovim

Kompania konsultuese ju ka përmbajtur të gjitha hapave që janë bazuar sipas udhëzuesi-për hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal nga fillimi deri në finalizimin e saj.

4. VIZIONI, MISIONI, QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Vizioni dhe misioni i komunës dhe vlerat kyçe janë elemente thelbësore të ngulitura në të gjithë kornizën për përsosmërinë e performancës në komunën e Shtimës. Si pjesë e profilit komunal është vizioni i saj, konkretisht arritja e qëndrueshmërisë ekonomike të komunës, si dhe, misioni i vazhdueshëm i komunës në mbështetje të realizimit të këtij vizioni. Për të mbështetur misionin dhe arritjen e vizionit të komunës, qëllimet dhe objektivat vendosen përmes proceseve të planifikimit strategjik. Vlerat thelbësore mbështesin këto qëllime dhe objektiva, gjithashtu lidhin së bashku dhe përforcojnë të gjitha vendimet dhe veprimet themelore operacionale.

Në vijim janë prezantuar vizioni dhe misioni i komunës së Shtimës.

Vizioni: - “Komunë që krijon mundësinë potenciale për zhvillimin e infrastrukturës të bizneseve, agrobiznesit dhe të shfrytëzimit të burimeve natyrore duke ruajtur ambientin dhe trashëgiminë”, kurse

Misioni: Përkrahjen e zhvillimit të NVM-ve, bujqësisë, turizmit, përmirësimi i infrastrukturës fizike, ngritja e cilësisë në arsim, shëndetësi dhe shërbime publike, ruajtjen e mjedisit dhe trashëgiminë kulturore.

5. SFONDI

5.1 ANALIZA E GJENDJES AKTUALE

Bazur në metodologji, në pjesën e parë të Strategjisë do të ketë një përshkrim të gjendjes aktuale të zhvillimit ekonomik lokal të Komunës. Gjendja aktuale duhet të përfshijë të gjitha informatat lidhur me qeshjet socio-ekonomike të Komunës të cilët duhet të jenë target për përmirësim gjatë zbatimit të Strategjisë. Grupi punues ka bërë identifikimin e problemeve dhe shkaqeve të tyre, sfidave dhe mundësive të zgjidhjes së tyre. Gjendja aktuale duhet të përfshijë informata lidhur me situatën socio-ekonomike, demografinë, bizneset, shërbimet publike etj.

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

Duke pasqyruar gjendjen aktuale të ofrimit të shërbimeve publike duhet të elaborohet për secilin shërbim gjendja aktuale dhe pasqyrohet një plan për përmirësimin e gjendjes aktuale për shërbimet si: shërbimet administrative, mirëqenia sociale, kulturë rini dhe sport, planifikimi urban, parqet dhe sheshet, rrugët, trotualet, transporti publik, parkingjet publike, ndriçimi publik, furnizimi me ujë, kanalizimi, grumbullimi i mbeturinave, deponimi i mbeturinave, etj.

Trajtimi i punësimit duhet pasqyruar këto të dhëna të nevojshme: vendi i të punësuarve në raport me popullsinë, punësimi sipas gjinisë, etnitetit, moshës, struktura e të punësuarve: sektori publik, të vetëpunësuar, të punësuar në sektorin privat; numri i të papunësuarve në raport me popullsinë dhe të punësuarit. Struktura e të papunësuarve sipas grup moshave dhe arsimimit; struktura e të punësuarve sipas degëve kryesore: në bujqësi, në agrobiznes, në degë të tjera me karakter industrial, në shërbime, në tregti; struktura e të punësuarve në sektorin publik: në administratë, në shëndetësi, në arsim etj.; numri i të punësuarve jashtë vendit.

Profili ekonomik i Komunës përmbledh të dhëna si: përmbledhje e karakteristikave kryesore të zhvillimit ekonomik; përmbledhje e tendencave kryesore të zhvillimit ekonomik; drejtimet kryesore të zhvillimit ekonomik si: degë me karakter industrial, zhvillimi i bujqësisë. Struktura e administrimit të tokës. Sistemet e kanalizimeve dhe ujitjes së tokës; sipërfaqet e kulturave kryesore. Trende, ndryshimi; përpunimi i produkteve bujqësore; zhvillimi i turizmit; zhvillimi blegtorisë; zhvillimi i pylltarisë; zhvillimi i sektorit privat dhe komunitetit të biznesit; shkalla e organizimit në shoqata; struktura e ndërmarrjeve dhe prodhimit; sektori publik; sektori privat.

Kjo pjesë është kyçe në identifikimin e objektivave dhe përcaktimin e aktiviteteve/masave për këtë arsyeje analizat dhe të dhënat e mbledhura në këtë fazë duhet të jenë sa më të kuptueshme.

5.1.1 Pozita dhe veçoritë gjeografike

Komuna e Shtimes është komunë në Republikën e Kosovës, ndodhet në Rajonin e Ferizajt ndërsa qendra administrative e komunës është vendbanimi i Shtimes. Komuna e Shtimes ndodhet në qendër të Kosovës. Në jug, komuna kufizohet me komunën e Ferizajt, në verilindje me komunën e Lipjanit dhe në perëndim me komunën e Suharekës. Së bashku me komunat e Ferizajt, Kaçanikut, Hanit të Elezit dhe Shtërpçës, që përbëjnë Rajonin e Ferizajit. Shtimja shtrihet në skajin perëndimor të Rrafshit të Kosovës. Kjo dhe rrethina e saj zënë vend në pjesën jugore të Kosovës. Koordinatat gjeografike të kësaj komunë janë në hemisferat gjeografike: 42° 26' dhe 21° 02'. Komuna e Shtimes përbën 1,2% të territorit të Kosovës. Rreth 48,4 % e territorit të komunës është tokë bujqësore. Komuna ka 23 vendbanime duke përfshirë edhe vetë selinë e komunës së Shtimes prej të cilave 13 vendbanime shtrihen në pjesën kodrinore – malore: Zborc, Carralevë, Belincë, Petrovë, Reqak, Mullopolc, Rancë, Topillë Llanisht, Dugë, Karaqicë, Devetak dhe Pjetërshticë, ndërsa 9 vendbanime prej tyre në pjesën rrafshinore: Gllavicë, Rashincë,

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

Davidovc, Muqezinë, Vojnovc, Gjyrkovc, Godanc i Eperm dhe I Ulët dhe Lagja Pajtimitt (Petroviq). Shumica e fshatrave të komunës janë të lidhura me selinë e komunës me rrugë të asfaltuara dhe momentalisht vetëm dy rrugë janë të paasfaltuara për fshatin Topillë dhe Devetak. Shtimje është trekëndësh gjeografik që lidhë Prishtinën me Prizrenin, poashtu Shkupin gjegjësisht Ferizajin me Prizrenin dhe anasjelltas. Distanca rrugore në mes” Shtimes dhe Prishtinës është 31 KM, nga Prizreni 51 KM dhe nga Shkupi 65 KM. Sipërfaqja e komunës së Shtimes është prej 134km² ose shprehur 13,450.8ha.

Pozicioni dhe ndarja e Komunës së Shtimeve sipas vendbanimeve - Në tabelën në vijim do të gjeni disa të dhëna statistikore në lidhje me: vendbanimet, sipërfaqja, tokë bujqësore, pyje, rrugë urbane, popullsia, numri familjeve, dendësia për banorë/km², rrugë komunale (km), rrugë urbane (km) etj.

Tabela 1 – të dhëna të përgjithshme statistikore të komunës së Shtimes

Qyteti	1	Tokë bujqësore (%)	48.40
Fshatra	22	Pyje (%)	47.40
Sipërfaqja (km ²)	134	Rrugë urbane (km)	15.54
Popullsia (banorë)	27,324	Rrugë komunale (km)	107.22
Numri familjeve	4,158	Dendësia për banorë/km ²	203.91
Meshkuj (%)	50,69	Femra (%)	49.31

5.1.2 Historiku i komunës së Shtimes

Njihet si njësi territoriale - administrative që nga fillimi i shekullit XX, më saktësisht që prej Luftës së Parë Botërore. Komuna humb statusin e saj më 1932 për shkak të politikës shoviniste serbe të udhëhequr nga Mbretëria e atëhershme jugosllave. Pas Luftës së Dytë Botërore (1945), Shtimja ka funksionuar sërish si komunë, për ta humbur statusin përsëri në vitin 1959. Më 9 qershor të vitit 1988 është rithemeluar Komuna e Shtimes dhe sot është qendër komunale administrative e 22 fshatrave dhe vetë vendbanimit të Shtimes, gjithësejt 23 vendbanime.

Në vendbanimet e komunës së Shtimes gjenden gjurmë të trashëgimisë historike e kulturore që prej kohës së neolitit, ilirëve, romakëve dhe vazhduar me ato të Perandorisë Osmane. Sipas defterit kadastral të vitit 1455 Shtimja i takonte Vilajetit të Vushtrrisë dhe ishte nën pushtimin osman. Në vitin 1566-74 i takonte Nahijes së Moravës me qendër në Prishtinë. Ndërsa në shekullin XIX i takonte Sanxhakut të Prizrenit.

5.1.3 Kushtet klimatike dhe relievi

Komuna e Shtimes ka klimë të mesme kontinentale, me dimra mesatarisht të butë dhe me verë mesatarisht të nxehtë. Temperatura mesatare vjetore është 10.5 gradë Celsius. Muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare -9 gradë Celsius, ndërsa më i ngrohti është korriku me 20.4 gradë Celsius. Mesatarja vjetore e reshjeve në territorin e komunës është 633 mm. Sasia më e lartë e reshjeve është regjistruar në muajin maj 81.3 mm, ndërsa ajo më e ulëta në muajin nëntor 41.7 mm. Mesatarja vjetore relative e lagështisë është 78.7%. Insolacioni vjetor është 2,153 orë. Vranësirat mesatare vjetore janë 52%.

Shpejtësia mesatare vjetore e erës është 1.3 m/s në drejtim jug -perëndim dhe 2.8 m/s në drejtimin veri-perëndim. Pika më e ulët mbidetare në komunën e Shtimes është 545.7 m, ndërsa pika më e lartë mbidetare është 1,290 m. Rreth 54 % e sipërfaqes së komunës i takon lartësisë mbidetare deri në deri 700 m, rreth 27 % e sipërfaqes së përgjithshme të komunës i takon lartësisë mbidetare 700-900 m, ndërsa që pjesa tjetër e sipërfaqes (rreth 17 %) që përfshinë kryesisht zonat malore i takon lartësisë mbidetare mbi 900 m.

5.1.4 Pedologjia dhe gjeologjia

Në kuadër të përbërjes pedologjike të tokave të komunës janë pjesëmarrëse tipet më përfaqësuese të tokave: Tokat kafeje, aluviale, deluviale, pseudogleje, smonica, livadhore dhe rendzinë. Kurse në areale të caktuara na paraqiten edhe tokat gurore, për më tepër shih në (Tabela 2). Tokat kafeje, smonicat, dhe rendezinat i takojnë rendit të tokave automorfike, ndërkaq, aluviumet dhe pseudoglejet dhe ato livadhore renditen si toka hidromorfike. Tipat dhe nëntipat e tokave kafeje, i përkasin klasës së tokave kambike dhe eluvialoiluviale. Këto toka për shkak të lagështisë më të madhe dhe ajrosjes optimale, krijojnë kushte të përshtatshme hidro-termike, të cilat ndikojnë në rrjedhën dhe intensitetin e proceseve pedogjenetike, posaçërisht, ato të alterimit kimik dhe biologjik, duke ndryshuar në tërësi strukturën e shkëmbinjve.

Tabela 2: Tipet e tokave kryesore në komunën e Shtimes

Tipet kryesore të tokave	Sipërfaqja ha	Sipërfaqja %
Toka aluviale	1,249.69	9.24
Toka livadhore-argjilore	1,090.29	8.06
Toka redezina	176.29	1.3
Toka smonice	872.07	6.45
Toka te kafta	8,768.34	64.85
Toka pseudoglej	909.59	6.73
Toka gurore	454.89	3.36
Gjithsej	13,422.16	100


Sa i përket bonitetit dominojnë tokat me klasë të VI (62.58%), ndërsa që tipet të tjera të bonitetit janë të përfaqësuara më pak si Klasa e bonitetit II (7.30%), Klasa e bonitetit III (11.03), Klasa e bonitetit IV (11.45), dhe Klasa e bonitetit V (5.68 %). Për nga potenciali prodhues këto toka janë mjaftë të mira por që janë në proceset e degradimit të vazhdueshëm evolutiv, erozionit dhe e punimit joadekuat. Me masa meliorative tipet e tokave me veti jo të mira mund të përmirësohen dhe të rritet prodhimtaria për njësi të sipërfaqes. Tokat bujqësore mund të grupohen në tetë klasë. Përqindja e tokave bujqësore sipas klasave në komunën e Shtimes është prezantuar në tekstin e më lart, për përcaktimin e klasës janë disa parametra: toka, Terreni dhe lartësia. Toka poentohet nga: tipi tokës, tekstura e tokës, thellësia e tokës, kullimi tokës, Terreni: pjerrtësia dhe Lartësia dhe Klima: reshjet atmosferike mesatare vjetore. Për më shumë informacione shih -

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

Udhëzimi administrative Nr. 02/2012 Për klasifikimin e përshtatshmërisë së tokës bujqësore:

Bazuar në analizat e hartës gjeologjike të Kosovës, struktura gjeologjike e komunës së Shtimes i takojnë formacioneve të Palezoikut, Triasikut, Jurasikut, Kreetenit të sipërm, Neogjenit dhe sedimenteve të Kauternerit. Një përbërje më e detajuar e formacioneve gjeologjike të komunës së Shtimes është prezantuar në figurën.

Harta gjeologjike e komunës së Shtimes



5.1.5 Pasuritë natyrore

Komuna e Shtimes njihet për rezervat e mëdha të gurit gëlqeror, të cilat sipas matjeve të kryera në vargmalet nga Carraleva në Topillë, janë rreth 2 milionë metra kub rezerva të cilësisë së lartë, ndërkohë që ka pritshmëri dhe për rreth 9 milionë metra kub rezerva të tjera të po kësaj cilësie, duke përbërë në këtë mënyrë një mundësi shumë të madhe dhe vazhdimësi për ngritjen e një industrie nxjerrëse dhe përpunuese për materiale që përdoren në sektorin e ndërtimit.

Territori i komunës së Shtimes është i pasur me lumenj. Lumi i Carralevës është një ndër bukuritë natyrore të zonës, në hyrje të Shtimes bashkohet me lumin i cili buron nga malet e Topillës, për t'u bashkuar më pas në qytetin e Shtimes me lumin Shtimjanja dhe duke vazhduar nëpër fshatra të pjesës rrafshore në komunën e Shtimes me lumin Sitnica.

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

Pellgu i lumit Shtimjanja ka një sipërfaqe prej 14km² dhe një gjatësi afër 15km. Përveç këtij lumi ekzistojnë edhe burime të tjera si ai në Qarrishtë, Reçak etj.

Rezervat ujore janë një resurs mjaft i mirë për zhvillimin e bujqësisë, si burim energjetik, por dhe si mundësi turizmi. Toka bujqësore përbën rreth 48,4 % të territorit të komunës dhe bujqësia është dhe mbetet një nga prioritetet zhvillimore të saj. Komuna ka rreth 6,697ha tokë bujqësore, prej të cilave 4,947ha janë pjellore. Kullotat zënë një sipërfaqe rreth 1,750ha, ndërsa pyjet 6,377.8 ha ose rreth 47.4 % të territorit të Komunës, nga të cilat 45.9% (2,926.8ha) janë publike dhe 54.1% (3,451 ha) në pronësi private duke përbërë një aks shumë të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

5.1.6 Numri i popullsisë

Komuna Shtime përfshin qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra me një popullsi prej 27,324 banorë¹, me rreth 4,158 familje dhe me një dendësi popullësie 203.91 banorë/km² dhe moshë mesatare 27.62 vjeç, ku prej tyre 13,850 janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 13,474 janë të gjinisë femërore. Në vazhdim në tabelën e mëposhtme prezantohet rritja e popullësisë sipas viteve të regjistrimit.


Tabela 3. Banorët e komunës së Shtimes sipas viteve të regjistrimit të popullësisë

Viti Regjistrimit	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011
Numri banoreve	9,834	10,801	12,523	15,528	19,952	23,519	27,324

Grafikoni: Banorët e komunës së Shtimes sipas viteve të regjistrimit të popullësisë

¹ Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011 - Agjencia e Statistikave të Kosovës

Banorët & vitet e regjistrimit



Pra siq shihet nga grafikoni kemi një rritje konstante dhe të njëtrajshme të popullsisë

Tabela 4 - Struktura e popullsisë sipas moshës

Grup moshat	Numri i grupmoshës f	Përqindja	Mosha mes-intervali x	f*x
0 - 9	5,428	19.87	4.5	24,426.0
10 - 19	6,124	22.41	14.5	88,798.0
20 - 29	4,443	16.26	24.5	108,853.5
30 - 39	3,970	14.53	34.5	136,965.0
40 - 49	3,016	11.04	44.5	134,212.0
50 - 59	1,988	7.28	54.5	108,346.0
60 - 69	1,386	5.07	64.5	89,397.0
70 - 79	725	2.65	74.5	54,012.5
80+	244	0.89	40	9,760.0
Gjithsej	27,324	100		754,770.0

Nga tabela e mësipërme shihet se popullata e komunës së Shtimes është e dominuar nga grup - moshat e reja.

Struktura e popullsisë që jetojnë në vise rurale dhe urbane ka këtë pjesëmarrje: Popullësia urbane me 7,255 banorë ose 26.55% dhe Popullsia rurale me 20,069 banorë ose 73.45%. Ekonomit familjare në komunën e Shtimes janë 4,158 me 6.57 mesatarja për familje.

Tabela 5. Strukturën e përkatësisë etnike

Përkatësia etnike	Numri	Përqindja
Nuk janë në dispozicion	19	0.07
Shqiptar	26,447	96.79

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

Serb	49	0.18
Turk	1	0.00
Boshnjak	20	0.07
Rom	23	0.08
Ashkali	750	2.74
Egjiptian	0	0.00
Goran	2	0.01
Të tjerë	13	0.05
Preferon mos të përgjigjet	0	0.00
Gjithsej	27,324	100

Norma mesatare vjetore e shtimit (nataliteti) sipas vitit 2011 është 536 lindje nga të cilat 290 të gjinisë mashkullore ndërsa 246 të gjinisë femërore ose shprehur në promilë është 19.61 ‰.

Norma mesatare vjetore e vdekjeve (mortaliteti) sipas vitit 2011 është 85 vdekje nga të cilat 55 të gjinisë mashkullore ndërsa 30 të gjinisë femërore ose shprehur në promilë është 3.11 ‰. Pra, mund të konkludojmë se shtimi natyror për vit në komunën e Shtimes është 16.5‰.

Sa i përket fenomenit të migrimit vlen të theksohet emigrimi i madh i të rinjëve dhe gjeneratës së mesme drejt vendeve Përendimore e veqanërisht Gjermanisë.

5.1.7 Arsimi

Sistemi arsimor në Kosovë nga viti 2002, është duke funksionuar sipas modelit 5+4+3. Sipas këtij modeli: 5 vite janë në arsimin fillor, pastaj vazhdohet me 4 vite të shkollimit të mesëm të ulët dhe 3 vite të shkollimit të mesëm të lartë.

Rrjedhimisht, struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Shtimes është e organizuar në tri nivele: arsimin fillor (klasët I – V), arsimin e mesëm të ulët (klasët VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasët X – XII), pra edhe komuna e Shtimes është në harmoni me sistemin arsimor në nivel vendi.

Drejtoria e Arsimit e komunës së Shtimes menaxhon 10 institucione edukativo-arsimore dhe aftësuese, një gjimnaz si dhe një shkollë të mesme profesionale, shtatë shkolla fillore dhe të mesme të ulëta me 9 paralele të ndara dhe një institucion parashkollor, përmes të cilave ofron shërbime për 4,992 nxënës, prej të cilëve 337 janë fëmijë parafillor dhe 130 fëmijë parashkollor (qerdhe).

Tabela 6 – të dhënat statistikore të institucioneve arsimore

Institucionet arsimore	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Institucioni parashkollor – çerdhja	63	67	130
Arsimi para fillor 5 - 6 vjeç	143	144	287
Arsimi fillor (1 – 5)	833	864	1,697
Arsimi i mesëm i ulët (6 – 9)	654	718	1,372

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

Gjimnazi (10 – 12)	295	277	572
Shkollat Profesionale (10 – 12)	141	251	392
Gjithsej	2,129	2,321	4,450

Politikat arsimore vendosen nga niveli qendror, ndërsa komuna luan rol të rëndësishëm në kuadër të kompetencave ligjore në mirëmbajtjen e ambienteve dhe në ofrimin e bashkëpunimit që synon rritjen e kapaciteteve dhe prioritetet e zhvillimit komunal.

Numri i mësimdhënësve është 364 dhe numri studentëve është 180 student.

Arsimi në komunën e Shtimes ballafaqohet me disa probleme, të cilat do të lehtësohen më poshtë, por brengosëse është zvogëlimi i numrit të nxënësve nga 5,897 në të dhënat e SZHEL 2019 – 2022 krahasuar në 4,450 nxënës në të dhënat e SZHEL 2024 – 2027. Kemi një rënje të numrit prej 1,537 nxënës ose shprehur në përqindja 25.67%. Dy arsye kryesore e dominojnë këtë zvogëlim jashtëzakonisht të madh brenda një periudhe kohore 2-3 vjeqare: Emigrimi masiv për vendet e Bashkimit Evropian dhe natalitetit i ulët. Por ky problem dominohet më shumë nga emigrimi.

Probleme tjera që janë identifikuar gjatë diskutimeve dhe analizës: Kushtet jo të përshtatshme në disa objektet shkollore, mungesa e digjitalizimit, mungesa e hapësirave të nevojshme për fëmijët parashkollor, infrastruktura sportive, mundesa e hapësirës për nxënës në vet vendbanimin e Shtimes.

5.1.8 Kultura dhe Sport

Në komunën e Shtimes zhvillojnë aktivitetin e tyre kulturore, artistike dhe sportive dhe janë të organizuara si: shoqëri kulturore artistike, klube sporti por të gjitha sipas ligjeve në fuqi në Kosovë janë regjistruar si OJQ - Ligji nr. 06/l-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare.

Janë disa institucione kulturore që menaxhohen nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport: Biblioteka e Qytetit dhe Muzeu i Qytetit, i themeluar gjatë vitit 2004 me qëllim ruajtjen e relikteve historike dhe njohjen e së kaluarës historike të trevës së Shtimes, e cila ishte mjaft e bujshme, me plot sakrifica e luftëra për liri.

Trashëgimia kulturore, janë identifikuar 14 objekte të trashëgimisë kulturore që janë në mbrojtje të përkohshme nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit duke përfshirë: xhamia, kisha, tyrbe, varreza e shumë objekte tjera, varrezat e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Shtime dhe Mollopolc, Kompleksi Memorial “Masakra e Reçakut”, varri i Ahmet Sylejmanit - Shtimja, kryetari i parë shqiptar në Shtime etj.

Tabela 7 – Objektet e trashëgimisë kulturore

Emri i objektit	Lokalitet	Kategoria e mbrojtjes
Gërmadhat e themeleve të	Petrovë	Lokalitet arkeologjik

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

kishës		
Gjyteti i Topillës (Guri i Markut)	Topillë	Lokalitet arkeologjik
Lokaliteti arkeologjik te Kisha	Reçak	Lokalitet arkeologjik
Gërmadhat e Kishës së Shortarisë	Reçak	Lokalitet arkeologjik
Xhamia e Shtimes	Shtime	Trashëgimi arkitekturore
Tyrbja e Shtimes	Shtime	Trashëgimi arkitekturore
Shtëpia e përshpëritshme	Shtime	Trashëgimi arkitekturore
Cezmja përkujtimore 1943	Zborc	Trashëgimi arkitekturore
Xhamia e fshatit	Reçak	Trashëgimi arkitekturore
Kroi i Xhem Osmanit	Reçak	Trashëgimi arkitekturore
Xhamia e fshatit	Pjetërshticë	Trashëgimi arkitekturore
Xhamia e fshatit	Gjergjaj	Trashëgimi arkitekturore
Xhamia e fshatit	Zotaj	Trashëgimi arkitekturore
Kulla e familjes Fejzullahu	Zotaj	Trashëgimi arkitekturore

Zbulime arkeologjike janë gjetur në disa vendbanime të kësaj treve. Ndër më të rëndësishmet janë ato të vendbanimit të vjetër në Petrovë, gërmadhat e kishës dhe lokalitetit arkeologjik në Reçak gjurmët e Gjytetit në Topillë etj. Lokalitete dhe gjurmë arkeologjike ka edhe në Mollopolc, Belincë, Carralevë etj.

Sporti në Komunë ka marrë një dimension të ri me përfundimin e palestrës sportive, aktualisht klubet sportive dhe shoqatat rekreative - sportive janë shumë aktive. Palestra e sporteve dhe Stadiumi i futbollit janë në funksion dhe operojnë dhe janë në funksion të futbolldashësve dhe sportisteve në përgjithësi. Në nivel komunal janë aktivë këto klube sportive: Klubi i hendbollit për femra dhe meshkuj, Klubi i futbollit meshkujt që garon në Ligën e parë të Kosovës, Klubi i Boksit, Klubi i Kik boksit, Klubi i Karatesë, pastaj kemi shoqatat rekreative - sportive Shoqata e peshkatarëve, Shoqata e bjeshkatarëve, Shoqata e sportit shkollor, motokros një sport atraktiv etj.

Objekti i Qendrës rinore në Shtime synon masivizimin e aktiviteteve me karakter kulturor dhe social të rinjve. Komuna e Shtimes ka të themeluar Këshillin e Veprimt Rinor Lokal të rinjve ku janë të përfshira 13 OJQ aktive, ku aktivitetin e saj e zhvillon edhe Ansambli Këngëve dhe Valleve "Ilirida". Problemet që janë definuar gjatë hartimit të kësaj strategjie janë: vazhdimi i identifikimit të objekteve tjera kulturore, trashëgimore, renovimi i tyre, mungesa e menaxhimit, mirëmbajtjes së tyre, investime të reja në infrastrukturë sportive, etj.

5.1.9 Shëndeti Publik dhe Mirëqenja Sociale

Kujdesi shëndetësor² në komunën e Shtimes është i organizuar dhe ofrohet përmes sektorit publik shëndetësor dhe atij privat. Komunitet janë përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre.

Kujdesi primar shëndetësor publik ofrohet përmes: Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) “ Dr Vezir Bajrami” në Shtime dhe katër Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF) në fshatrat: Muzeqinë, Godanc i Ulët, Muzeqinë dhe Pjetërshicë. Veprimtari e QKMF-së është ofrimi i shërbimit parësor shëndetësor për qytetarët e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës. Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që banorëve të komunës së Shtimes dhe të tjerëve, sipas shtrirjes territoriale dhe gjeografike, t’u ofrojë shërbim shëndetësor gjithëpërfshirës, të bazuar në të dhëna shkencore dhe efikase, përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për pacientët në sistemin shëndetësor dhe, njëherit, pikë referuese në nivele të tjera të kujdesit shëndetësor dytësor dhe tretësor.

Shërbimet sociale profesionale dhe asistencë sociale për qytetarët tanë ofrohen përmes Qendrës për Punë Sociale (QPS), në Shtime, ku funksionojnë dy shërbime:

- a. Shërbimi Social Profesional dhe
- b. Skema e Ndhimave Sociale.

QPS e ka statusin e institucionit juridik dhe publik, ku ofrohen përkujdesje dhe shërbime adekuate sociale profesionale si dhe forma të mbrojtjes sociale, në bashkëpunim me partnerët e tjerë, për çdo kategori të qytetarëve në nevojë sociale e familjare, konform legjislacionit në fuqi, që ndërlidhet me këto shërbime.

Shërbimet rezidenciale institucionale ofrohen përmes Shtëpisë së Komunitetit për persona me aftësi të kufizuar mendore në Shtime. Ky shërbim ka kaluar në kompetencë dhe menaxhim të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale (MPMS) - së nga 1 janari i vitit 2016, në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit, e lidhur në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale dhe Komunës së Shtimes, e nënshkruar nga Ministri dhe Kryetari të atëhershëm të komunës. Komuna Shtimes tani është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve rezidenciale - institucionale nën mbikëqyrjen e MPMS. Ofrimi i shërbimeve rezidenciale kryhet duke u bazuar në programin e shërbimeve të identifikuar, në përputhshmëri me standardet minimale të caktuara, duke respektuar rregulloret, udhëzimet administrative, ligjet dhe procedurat e përcaktuara nga MPMS.

²Komuna e Shtimes, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

Gjithësejt janë 10 mjekë që punojnë në QKMF dhe numri banorëve për një mjek është 2,700 banorë, 20 infermier janë gjithësejt dhe numri i banorëve për një infermier është 1,350 banorë, numri i vizitave vjetore nga mjeku janë **71,694**, kurse shërbime mjekësore infermiere janë 23,068.

Shtëpia e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore në Shtime ka kapacitet prej 12 shtretërve për pacientë, 10 resident dhe 10 punëtorë që kujdesen për shërbimet ndaj tyre (prej tyre 9 kujdestar dhe udhëheqësi). Organizimi i punës në këtë Qendër bëhet në orar 24 orësh.

Problemet me të cilat ballafaqohet komuna e Shtimes në sektotin e shëndetësis dhe mirëqenjes sociale janë: mungesa e hapësirës e cila kërkohet sipas standardeve për funksionimin e QKMF, mungesa e pasisjeve teknologjike në shëndetësi, renovimi i QMF, renovimi QPS e tjera.

5.1.10 Infrastruktura fizike

Një pasqyrë e infrastrukturës përmbledh këto të dhëna: gjatësia në kilometra e rrugëve të asfaltuara që përshkojnë komunën, ujësjellësi, kanalizimi atmosferik, kanalizimi fekal, trotuarët, hapësira e gjelbër dhe ndriqimi publik.

Tabela 8 - Investimeve në infrastrukturë e shprehur në njësi matëse (km, m²)³

Viti i realizimit	Rrugë të asfaltuara (km)	Ujësjellës (km)	Kanalizimi atmosferik (km)	Kanalizimi fekal (km)	Trotuar e (km)	Hapësira të gjelbëruara (m ²)	Ndriçi m publik (km)
2000	-	5	-	-	-	-	-
2001	-	6	1	0	-	-	-
2002	-	6	0	2	1	-	-
2003	1	30	-	-	-	-	-
2004	-	20	1	2	1	-	-
2005	3	14	0	-	-	-	-
2006	1	15	-	-	1	-	-
2007	4	1	2	-	2	2,000	-
2008	9	1	1	-	2	-	-
2009	26	2	4	8	4	1,400	-
2010	1	2	1	4	3	1,200	-
2011	7	1	-	11	3	300	6
2012	20	1	-	11	-	-	-
2013	51	1	1	14	-	500	2
2014	33	3	3	6	3	-	1
2015	4	-	0	12	4	8,881	2
2016	3	1	1	4	2	830	2
2017	1	-	1	1	1	1,320	1

³ Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

2018	15	-	13	9	8	9,195	3
2019	21	-	3	10	3	820	2
2020	9	-	2	10	5	650	17
2021	8	-	1	7	15	1,350	11
2022	5.08		0.43	2.47	4.6	1580	4.7
Gjithsej	222.08	109	35.43	113.47	62.6	30026	51.7

Problemet që janë identifikuar në infrastrukturë ku janë përfshirë në këtë tabelë janë të shumta dhe kërkesa për investime duke filluar me investime të reja dhe renovime, është shumë e lartë dhe se këto investime gjatë përpilimit të strategjise, janë hasur edhe në kornizën afatmesme buxhetore dhe në vet planifikimet e strategjisë.

5.1.11 Transporti

Transporti në veçanti dhe komunikacioni në tërësi është parakusht për zhvillimin ekonomik dhe social të një territori. Komuna e Shtimes karakterizohet me transport rrugor i cili përshkohet prej dy rrugëve magjistrale dhe dy rrugëve regjionale si dhe rrugë të tjera lokale. Rrugët magjistrale janë rruga Prishtinë-Prizren (M25) dhe rruga Shtime-Ferizaj (M25.3), kurse rrugët regjionale janë rruga Carralevë - Komoran (R102) dhe rruga Gjurkovc - Koshare (R207). Përgjatë këtyre akseve rrugore zhvillohet transporti ndër-urban dhe kryesisht është i mbuluar nga kompanitë regjionale të transportit publik të Prishtinës, Prizrenit dhe Ferizajt, si dhe nga 3 kompani lokale.

Qyteti i Shtimes edhe pse është kryeqendër komunale nuk ka stacion të autobusëve. Rreth 71% e rrugëve (80 km rrugë) që shtrihen në territorin e komunës së Shtimes janë rrugë lokale, dhe janë nën menaxhimin e Komunës së Shtimes. Vetëm gjatë peridudhës kohore 2005-2022, me investime vetanake komuna e Shtimes ka asfaltuar 222 km rrugë.

Qyteti i Shtimes nuk e ka të zhvilluar transport urban, arsye e mungesës së transportit urban shpjegohet me faktin që prej qendrës së qytetit, gati i gjithë qyteti mbulohet me një rreze prej 1000 m. Transporti publik ka shtrirje të kënaqshme dhe nga 23 vendbanime sa ka komuna 17 prej tyre kanë qasje në transportin publik, që menaxhohet nga kompanitë private.

Rreth 98% e popullatës së Komunës është e vendosur kryesisht në vendbanimet e mëdha, afër rrugëve të karakterit nacional, fushave dhe luginave lumore që kanë qasje në transportin publik. Kurse, vetëm 2% e popullatës e cila është e vendosur në vendbanimet kodrinoremalore nuk kanë transport publik të organizuar, ku disa vendbanime tani veq janë boshatisur nga banorët rezident (Duga, Devetaku, Karaqica, Topilla, Llanishti dhe Ranca). Por nëpër këto vendbanime tani janë duke u zhvilluar forma të ndryshme të aktiviteteve ekonomike, siq janë turizmi dhe bujqësia.

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

Komuna e Shtimes ka të hartuar dhe të miratuar Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm, që është një plan strategjik që ka për qëllim të përmirësimin dhe harmonizimin e nevojave për lëvizje për të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Një nga objektivat e këtij plani është edhe zvogëlimi i ndotjes së mjedisit.

Në kuadër të objektivave tjera të këtij plani që ndërlidhen me trafikun janë edhe: rritja e sigurisë në trafik në afërsi të shkollave, përmirësimi i sinjalizimit dhe rregullimi i qarkullimit, rregullimi i parkingjeve, rregullimi i shtigjeve për ciklistë dhe përshtatja e infrastrukturës rrugore për persona me aftësi të kufizuara.

Problemet kryesore në lidhje me transportin publik janë mungesa e stacioneve të autobusave në gjithë komunën e Shtimes, në vet vendbanimin dhe fshatrat për reth të cilat janë të banuara.

5.1.12 Ekonomia

Një prej institucioneve më të rëndësishme që vepron në komunë është Drejtoria për Zhvillim Ekonomik⁴. Drejtoria ofron mbështetje të plotë zhvillimit të biznesit dhe atij ekonomik në komunë. Në bashkëpunim të ngushtë me qendrën biznesore komunale, administrata komunale ofron një varg shërbimesh biznesore, duke filluar nga shërbimet për regjistrim të biznesit deri në mbështetje të plotë të investuesve. Administrata i kushton vëmendje të madhe efikasitetit kështu që gjitha kërkesat e komunitetit biznesor procedohen me shpejtësi dhe kujdes të veçantë për t'i plotësuar të gjitha nevojat e tyre. Duke e parë nevojën e krijimit të një mjedisi të përmirësuar biznesor, komuna ka ndërmarrë një nismë për ofrimin e vëmendjes së veçantë tërheqjes së investimeve, përmes ofrimit të mundësive të ndryshme, me fjalë tjera, me zvogëlim të tatimit, me stimulim dhe beneficione tjera preferenciale investuesve. Krahas kësaj, komuna ka adoptuar një qasje më pro-aktive ndaj partneritete publike-private dhe dhënies së tokës koncesionale për tërheqje të investimeve. Një e dhënë me rëndësi është edhe mbledhja e informatave më të fundit mbi pronën komunale që na ofron Planin Zhvillimor Komunal 2009- 2020. Kjo tregon që shfrytëzimi i këtyre pronave mund të sjell zhvillim ekonomik të qëndrueshëm nëpërmjet të cilit mund të krijohen vende pune si dhe rritje të hyrave vetanake që do të mund të shfrytëzoheshin nga komuna për përmirësimin efektiv të infrastrukturës dhe shërbimeve tjera komunale.

Që nga muaji korrik i vitit 2012 funksionon zyra për regjistrimin e bizneseve “one stop shop”- e cila përveç regjistrimit të bizneseve ajo ju ofron edhe këshilla, trajnime në fushën e të bërit biznes dhe informacione se si do të kenë qasje në kuptimin e asaj për nevoja dhe projekte. Bizneseve të komunës së Shtimes kjo zyre tani po u shkurton koston financiare edhe atë të kohës që janë dy faktorë që i duhen më shumë biznesit. Kjo zyre është një aktivitet shtesë dhe përmirëson klimën e të bërit biznes.

Zyra për Regjistrimin e Bizneseve synon të përmirësojë ambientin e biznesit në Shtime, me qëllim të rritjes së zhvillimit ekonomik dhe punësimit. Më këtë thjeshtësohen dhe

⁴ Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

lehtëson procedurat administrative për regjistrimin dhe licencimin e bizneseve në kuadër të komunave, mandej zvogëlojnë kohën, procedurat dhe shpenzimet.

5.1.12.1 Struktura ekonomike

Në komunë e Shtimes zhvillojnë aktivitetin 1,053 biznese⁵ (deri më Shtator 2023), struktura sektoriale e të cilave është si në tabelle.

Tabela 9 – struktura e bizneseve dhe pronësia sipas gjinisë

Nr.	Aktivitetet	Meshku j	Femr a	Gjithsej bizneset e regjistruar a	%	Numri i punëtorëv e
1	A-Bujqësi, Pylltari dhe Peshkimi	111	25	136	6.23	284
2	B-Minierat dhe Guroret Industria Nxjerrëse					
3	C-Industria Përpunuese	257	35	292	13.37	690
4	D-Furnizimi me Rrym, Gaz, Avull dhe Ajër të Kondicionuar	4	1	5	0.23	10
5	E-Furnizim me Ujë, Kanalizim, Aktivitetet e Menaxhimit dhe të Trajtimin të Mbeturinave	3	1	4	0.18	4
6	F-Ndërtimtaria	244	6	250	11.45	613
7	G-Tregti me Shumicë dhe Pakicë; Riparimi i Mjeteve Motorike dhe Motoqikletave	657	66	723	33.10	1343
8	H-Transporti dhe Magazinimi	186	3	189	8.65	231
9	I-Hoteleri dhe Akomodimi	208	20	228	10.44	442
10	J-Informimi dhe Komunikimi	30	3	33	1.51	53
11	K-Aktivitetet Financiare dhe të Sigurimit	3	2	5	0.23	5
12	L-Aktivitetet e Patunëshmeris	5	1	6	0.27	⁹
13	M-Aktivitetet Profesionale, Shkencore dhe Teknike	41	9	50	2.29	90
14	N-Shërbimet	26	5	31	1.42	41

⁵ Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

	Administrative dhe Mbështetëse					
16	P-Arsimi	10	7	17	0.78	56
17	Q-Aktivitetet e Shëndetit të Njeriut dhe të Punës Sociale	32	7	39	1.79	71
18	R-Artet, Argëtimi dhe Rekreacioni	42	9	51	2.34	105
19	S-Aktivitetet e Tjera Sherbyese	82	43	125	5.72	147
Gjithsej		1,941	243	2,184	100	4,194

Nëse krahasojmë numrin e bizneseve krahasur nga momenti i aprovimit të SZHEL 2029-2022 (1,745 biznese) dhe SZHEL 2024 – 2027 (2,184 biznese) para aprovimit difference është e rëndësishme për 439 biznese ose shprehur në përqindje për 20% dhe numri i të punësuarëve në rastin e parë 3,106 kurse në rastin e dytë 4,194 të punësuar, me një difference 1,088 të punësuar dhe kjo tregon se është rritur numri i të punësuarëve ose është zvogëluar numri i të punësuarëve në ekonominë e zezë. Numri i të punësuarëve është rritur për 1,018 ose shprehur në përqindje për 26%.

5.1.12.2 Zonat Ekonomike - Parku Teknologjik në Shtime 1, Parku teknologjik në Gllavicë dhe Parku teknologjik Davidovc

Komuna e Shtimës ka Zonën Ekonomike në operim të plotë e cila gjendet në kilometrin e dytë në rrugën magjistrale Shtime - Ferizaj (M-25.3). Zona përfshin një sipërfaqe prej 10.7ha. Në Parkun Teknologjik në Shtime janë të vendosura 12 biznese, dhe se të gjitha kanë filluar veprimtarinë. Numri i të punësuarëve në Parkun Teknologjik është 300 punëtorë të rregullt dhe ofro 100 sezonalë, ndërsa vlera e planifikuar dhe realizuar e investimeve vlerësohet se është 9,968,200€.

Në komunën e Shtimës është në fazën finale vendosja në funksion e zonës së dytë ekonomike në kodrën e Gllavicës, me një sipërfaqe prej 37.5 ha. Tani komuna është në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm që të aplikojnë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për marrjen e Pëlqimit të kësaj zone të re ekonomike.

Por kjo zone ekonomike ende ballafaqohet me disa probleme të cilat duhet të zgjidhen, toka ku është i vendosur ky park teknologjik i takon klasit të IV dhe sipas ligjeve në fuqi nuk lejohet për shëndërimin në park teknologjik, por së shpejti kjo qështje do të zgjidhet me që komuna e Shtimes ka bërë një kërkesë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në divizionin e tokave, ku pas këtij aprovimi fitohet statuti i zonës ekonomike. Po ashtu rrugët lolake që lidhen me këtë park teknologjik janë të lejueshme vetëm për transport deri në 7 ton. Kështu që duhet të vendoset në ndërtimin e një rrugë e cila lidhë parkun teknologjik me rrugën rrugën magjistrale Shtime - Ferizaj (M-25.3). Problem tjetër i cili ka ndikim krucial në tërheqjen e investitorëve është furnizimi i investitorëve me energji elektrike por duhet marr në konsiderim se konsumatorëve për

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

fshatrat dhe qytezën e Shtimes realizohet realizohet nëpërmjet nënstacionit 35/10 kv Shtimia me fuqi të instaluar prej 2x8 MVA, kurse ka një memorandum për investime me KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës në ndërtimin e një NS me kapacitet 110/35/10(20) me fuqi 2x31.5+40 MV.




Foto 1 – zona teknologjike 1

Kurse te zona biznesore në Davidovc si problem është potencuar që kjo zonë duhet të lidhet me trotuar dhe shteg bicikletash nga Gjyrkoci në Qendër me qëllim të lëvisjes së fuqisë punëtore.

5.1.13 Bujqësia

Komuna e Shtimes e ka në traditën e saj marrjen me bujqësi⁶, veçanërisht kultivimin e drithërave të bardha si grurin, misrin, thekrën, tërshërën dhe disa kultura të pemëve frutore: faroret, bërthamoret dhe aroret si dhe pemë të imta: dredhëza, mjedra, kultura perimore në ambiente të mbyllura dhe ambient të hapur: specat, domate, tranguj, lakra etj, si rrjedhojë e sipërfaqes së madhe të tokës bujqësore dhe pjellorisë së saj, por edhe të burimeve të mëdha ujore dhe kapaciteteve njerëzore që zotëron.

Sipas regjistrimit të bujqësisë të realizuar në vitin 2014 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komuna e Shtimes ka 2,516 ekonomi bujqësore, 6,128 hektarë tokë bujqësore dhe 4,352 njësi blegtorale.

⁶Komuna e Shtimes, Sektori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

Sa i përket fondit blegtoral, dominojnë gjedhet me 346 krerë të 43 fermer me mbi 5 lopë, delet me 1,359 krerë me 13 fermer mbi 30 dele dhe dhitë me 607 krerë me 7 fermer mbi 30 copë. Në territorin e komunës operojnë, 11 ferma për trashjen e viçave me mbi 10 copë krerë, 3 ferma të pulave për prodhimin e vezëve me mbi 23,000 pula vojse dhe një fermë për prodhimin e zogjve për konsum me kapacitet prej 3,600 zogj, ndërsa që numri total i pulave në territori në komunës konsiderohet të jetë 70,000 pula nëpër ekonomitë bujqësore familjare për konsum vetanak.

Gjatë viteve të fundit një zhvillim të veçantë ka marrë edhe rritja dhe kultivimi i bletës, ku sipas të dhënave janë aktiv 34 bletarë me gjithsej 2,256 shoqëri bletësh me mbi 30 familje.

Sa i përket kultivimit të kulturave bujqësore dominojnë drithërat e në veçanti gruri dhe misri (tabela 8). Sipërfaqja me serra është mbi 5.15 ha janë serra. Në komunë e Shtimes janë të vendosur edhe 4 serra model në nivel vendi.

Tabela 10: Sipërfaqet e kulturave bujqësore sipas llojeve⁷

Llojet e kulturave bujqësore	Sipërfaqja ha
Gruri	1,308
Misri	1,060
Drithëra tjera (elb, tërshërë)	11
Bishtajore (fasule)	0.59
Patate	4.5
Pjepra dhe shalqinj	4.5
Qepë	5
Kultura foragjere dhe kungujt	411
Perime	22.5
Toka djerrina	52
Arra	10
Mollë	28.5
Kumbulla	23
Lajthi	6
Gjithsej toka të punueshme	2,947

Rreth 88 ha të sipërfaqes së tokave bujqësore në komunën e Shtimes është e përfshirë në sistemet e ujitjes. Që nga viti 2014 në Parkun Teknologjik operon Qendra e Agrobiznesit, e cila tregton pemë dhe perime brenda dhe jashtë Kosovës.

Problemet që ballafaqohet sektori bujqësisë janë: fragmetimi tokave, mungesa e investimeve në hapjen e rrugëve fushore, kanaleve të kullimit, legjislacioni në nivel vendi që kërkon që objektet e fermave blegtorale të vendosen 500 metra nga vendanimi, zona e Gllavicës të ketë një pjesë të ndarë vetëm për zhvillime në bujqësi ndaras nga industrit tjera, mungesa e shoqatave dhe kooperativave.

⁷ Regjistrimi i Bujqësisë, ASK 2015

5.1.14 Turizimi

Në komunën e Shtimes janë të shpallura 3 zona turistike: Llanisht - Topillë, Rancë-Carralevë dhe Dugë - Karaqicë. Vlera më e madhe në turizëm është pjesa malore, e cila gjendet në perëndim të qytetit, në fshatrat: Mollopolc, Devetak, Llanisht, Topillë, Rancë, Carralevë dhe Dugë. Në këto vargmale ka peizazhe natyrore shumë të bukura. Në këto zona gjenden mbi 200 burime të ujit, po ashtu atraksion i veçant janë Shpella e Imer Devetakut dhe Shpella e Lakuriqëve. Është shpallur edhe zona turistike Mollopolc-Devetak, e cila ka bukur natyrore, në veçanti ujëvara e Mollopolcit, mbi 90 burime të ujit, lumi dhe pyjet e bukura.

Një zonë tjetër rekreative që ndodhet afër qytetit të Shtimes, është parku i pishave, që po ashtu ka edhe statusin e zonës së mbrojtur të natyrës me sipërfaqe rreth 15 ha.

Atraksion i veçantë është edhe resorti i njohur në nivel vendi – Liqeni Mjellmave.




Foto 2: Liqeni Mjellmave – agroturizmi

Potenciale tjera për zhvillimin e turizmit në Komunën e Shtimes janë edhe objektet e trashëgimisë kulturore, natyrore dhe historike që ndodhen në territorin e komunës ndër të cilat duhet veçuar: Kështjella mesjetare e Topillës, Kalaja e Petrovës, Kulla e Agush Agës, Tyrbja E Shtimes, Vendlindja e Ahmet Shtimes, Xhamia e Vjetër e Shtimes, Xhamia e Rashincës Xhamia e Carralevës, Kulla e Muhamet Begut, Kulla e Sherif Agës në Vojnovc, Kulla e Ramë Sylës së Vojnovcit, Kulla e Sahitit në Carralevë, Shkolla e Parë në Shtime, Shtëpia e Përshpirtshme, Kisha Ortodokse e Mihail Arkangjelit të Shenjtë, Shpella e Pjetërshticës, Shpella e Imer Devetakut - Devetakë, Gryka e Llanishtit, Kompleksi Përkujtimor “Masakra E Reçakut” – Reçak etj.



Foto 3: Mulliri shekullor i familjes Salihi në fshatin Llanishtë

Komuna e Shtimes ka përgaditur dhe miratuar Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit Rural 2015-2019, dhe se kjo strategji ende nuk është hartuar pas asaj periudhe kohore.

Problemet kryesore janë se ende nuk ka filluar zbatimi i asaj strategji dhe se mungojnë investimet.

5.1.15 Sektori minerar

Komuna e Shtimes njihet për rezervat e mëdha të gurit gëlqeror, të cilat, sipas matjeve të kryera në vargmalet nga Carraleva në Topillë, janë rreth 2 milionë metra kub të cilësisë së lartë, ndërkohë që ka pritshmëri dhe për rreth 9 milionë metra kub rezerva të tjera të po kësaj cilësie, duke përbërë, në këtë mënyrë, një mundësi shumë të madhe për ngritjen e një industrie nxjerrëse dhe përpunuese për materiale që përdoren në sektorin e ndërtimit. Megjithatë sektori i shfrytëzimit të resurseve minerare është një ndër sektorët që ka ndikim në mjedis në këtë komunë, duke përfshirë ndotjen e ajrit, rrezikimin e komunikacionit dhe degradimin e sipërfaqeve të tokës.

Sipas të dhënave në territorin e komunës operojnë rreth 50 operatorë të shfrytëzimit të resurseve minerare disa nga të cilët nuk kanë licenca. Për një dukuri të tillë ka pasur ankesa edhe nga banorët e zonave ku operojnë këtë operatorë por edhe ankesa dhe reagime edhe nga organizatat e shoqërisë civile. Madje ka pasur raportime ku është vlerësuar se këta gurëthyes ndodhen shumë afër vendbanimeve.

Tre nga shembujt e këtyre gurëthyesve që kanë qenë pjesë e debateve dhe trajtimit nga organizatat e shoqërisë civile janë një gurëthyes në Carralevë dhe dy gurëthyes në Belincë⁸.




Foto 4: Gurëthyesi në Carralevë

5.1.16 Mjedis (resurset ujore dhe menaxhimi i tyre)

Lumi kryesor në territorin e Komunës së Shtimes është lumi Shtimjanja. Ky lum grumbullon edhe ujërat e lumit të Carralevës, Topillës dhe Mollopolcit. Sipërfaqja e pellgut të lumit Shtime është 102 km², me një prurje vjetore prej 32.26 milion m³.

Ujërat nëntokësorë në territorin e kësaj komune mund të gjenden përgjatë lumit Shtimjanja. Sipërfaqja e përgjithshme ujore e komunës përbëhet nga 96.6 ha lumenj, 6.18 ha përrenj dhe 2.61 ha kanale ujore. Sipërfaqja totale e tokave ujore është 105.39 ha ose 0.78% e territorit të përgjithshëm të komunës⁹.

Cilësia e ujit sipërfaqësorë (të lumenjëve) në territorin e komunës së Shtimes, monitorohet në dy pika monitoruese, në Devetak dhe në Vojnovc, të cilat ndodhen në lumin Shtimjanja, që i takon pellgut të Ibrit. Në këto pika monitoruese, monitorimi kryhet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK), dhe monitorohen 10 parametra fizikë, 39 parametra kimik dhe 8 metale të rënda. Sipas vlerësimit të Agjencisë për Mbrotjtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), sa i përket parametrave fizik dhe kimik, bazuar në të dhënat e monitorimit në njërin nga stacionet monitoruese (Devetak), cilësia

⁸ Pyje për Asfalt, Kosovo Democratic Institute (KDI) 2020.

⁹ Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Shtimes

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

e ujit nuk është e ndikuar shumë në faktorët e jashtëm nga aktivitetet njerëzore dhe cilësia e ujit është shumë e mirë, ndërsa në pikën e dytë monitoruse (Vojnovc) e cila ndodhet pas shkarkimeve të të gjitha ujërave urbane nga të gjitha fshatrat për rreth dhe të vetë qytetit të Shtimes, cilësia e ujit të këtij lumi është e dobët. Në këtë gjendje ka ndikuar shkarkimi i ujërave nga aktivitetet e ndryshme prodhuese, urbanizimi dhe bujqësia.

Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve ujore në territorin e Komunës së Shtimes. Burim i ndotjes së lumenjëve në komunën e Shtimes, janë mbeturinat që hidhen në këta lumenjë dhe derdhja e ujërave të zeza direkt në lumë pa ndonjë trajtim paraprak.

Problem i identifikuar në kuadër të kërkesave të qytetarëve përfshihen edhe nevojat për investime në pastrimin, zgjerimin dhe rregullim të atij lumi të Shtimes.

Sa i përket përdorimit të burimeve ujore për pije, janë 9 burime të resurseve ujore që furnizojnë banorët e komunës me ujë të pijes. Shumica e këtyre resurseve janë burime ujore nëntokësore. Kapaciteti total i resurseve ujore që përdoren për pijë në territorin e komunës së Shtimes është rreth 80 l/s.¹⁰

Cilësia e ujit të pijes i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike. Cilësia e ujit të pijshëm është një tregues i rëndësishëm për mirëqenien dhe shëndetin e popullsisë. Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2012, dhe Udhëzimin Administrativ Nr.15/2017, janë aktet nënligjore që e rregullojnë mbrojtjen e ujërave të pijshëm. Sa i përket përgjegjësisë institucionale Kompanitë Regjionale të Ujësjellësit (KRU) kanë përgjegjësinë për të furnizuar me ujë cilësor për konsumatorët e tyre, ato gjithashtu kanë obligim për të bërë monitorimin/testimin intern të kualitetit të ujit. Ndërsa Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik (IKSHPK), është institucion përgjegjës për kontrollin dhe monitorimin e ujërave të pijshëm në tërë territorin e vendit. IKSHPK ka obligim që të sigurojë që uji i distribuar nga KRU është në përputhje me vlerat sipas standardit vendore për parametrat mikrobiologjik dhe fiziko-kimik.

Komuna e Shtimes, ndodhet në zonën e shërbimit të KRU Prishtina. Sipas raporteve të IKSHPK, cilësia e ujit të pijes për zonën e KRU Prishtina, sa i përket parametrave mikrobiologjik ka përputhshmëri me standardet 99.9%, ndërsa përputhshmëria me parametrat kimik është 96.6%¹¹.

Edhe përkundër investimeve të shumta në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimeve ka ende nevojë për investime në këto dy kategori bazike të shërbimeve publike. Në disa lokalitete problematike është ende furnizimi i vazhdueshëm me ujë të pijshëm. Ndërpërja e furnizimit me ujë të pijshëm ndodhë sidomos gjatë stinës së verës.

¹⁰ *Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Shtimes 2010 - 2020*

¹¹ *Cilësia e ujit të pijshëm në Kosovë 2016, IKSHPK.*

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

Sipas të dhënave të Kompanisë Ujësjellësi Rajonal Prishtina, në Komunën e Shtimes qasje në sistemin e ujësjellësit kanë 3,522 ekonomi familjare ose 85% e 4,158 numrit total të ekonomive familjare¹².

Vetëm gjatë periudhës kohore 2001-2021, në Komunën e Shtimes janë rregulluar 176 km të rrjetit të ujësjellësit. Në të njëjtën periudhë kohore, janë rregulluar edhe 28 km kanalizim atmosferik dhe 86 km kanalizim për ujëra të ndotura urbane¹³. Ndërsa qasje në sistemin e kanalizimit kanë 4004 ekonomi familjare ose 96% e numrit total të ekonomive familjare, nga gjithsejt 4,158 ekonomi familjare.

Problemet kryesore në lidhje me menaxhimin e resurseve ujore janë: Shkarkimi i ujërave të zeza në lumenjë pa trajtim paraprak, degradimi i shtretërve të lumenjëve dhe mbrojtja jo efikase e rrjedhave dhe burimeve ujore.

5.1.17 Ajri dhe zhurma

Ajri është një element mjaft i rëndësishëm për shëndetin e njeriut dhe në përgjithësi mjedisit që na rrethon. Ajri është vazhdimisht nën ndikim të ndotjes nga shumë burime. Edhe pse ndotja e ajrit vjen kryesisht nga aktivitetet njerëzore, ai gjithashtu mund të ndikohet edhe nga fenomenet natyrore.

Në komunën e Shtimes, nuk ka ndonjë stacion nacional apo lokal të monitorimit të cilësisë së ajrit, prandaj nuk ka të dhëna të cilave mundë ti referohemi për të vlerësuar cilësinë e ajrit në këtë komunë. Por nëse marrim për bazë të dhënat nga stacionet tjera dhe ngjashmëritë që ka komuna e Shtimes me lokalitetet tjera ku behët monitorimi i ajrit, vlerësohet dhe pritët që problemi kryesor të jetë ndotja me grimcat PM10 dhe PM 2.5 microna.

Komuna e Shtimes, nuk ka ndonjë industri të zhvilluar që do të ishte burim i ndotjes së ajrit. Andaj burimet kryesore të ndotjes së ajrit janë ekonomitë familjare, institucionet publike që përdorin lëndë djegëse për ngrohje, transporti dhe operatorët e shfrytëzimit të gurit.

Problemet të cilat janë identifikuar: cilësia jo e mirë e ajrit në zonat urbane; mungese e inventarit të ndotësve të ajrit; mungesa e Planit Lokal të Veprimtë për Cilësi të Ajrit; mungesa e Planit Lokal për Mbrojtje nga Zhurma dhe furrat e gëlqerës dhe gurëthyesit janë burim i emetimit të ndotësve në ajër.

5.1.18 Menaxhimi mbeturinave

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është ende në fazën e zhvillimit dhe avancimit. Në komunën e Shtimes gjatë viteve të fundit është shënuar progres në menaxhimin e mbeturinave. Problemet kryesore për sektorin e menaxhimit të

¹² Kompania, Ujësjellësi Rajonal Prishtina

¹³ Komuna e Shtimes, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

mbeturinave të ngurta janë identifikuar dhe janë adresuar për zgjidhje përmes **Planit për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Shtimes 2016-2021**.

Komuna po ashtu ka hartuar edhe **Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave** në territorin e saj, që ka qëllimi të rregulloj çështjen e menaxhimit të mbeturinave nën përgjegjësi të Komunës në mënyrë të integruar. Me këtë rregullore përcaktohet orari, sistemi dhe kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave, llojin, numrin dhe mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjes së kontejnerëve, mirëmbajtjen e vendeve ku grumbullohen ato dhe mënyra e transportimit¹⁴.

Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave në komunën e Shtimes nuk shtrihen në të gjitha vendbanimet e komunës, dhe nuk përfshinë të gjitha ekonomitë familjare. Nga numri i përgjithshëm i ekonomive familjare të komunës së Shtimes (4,158 ekonomi familjare), rreth 3,105 ekonomi familjare ose 73 % e tyre janë të përfshirë me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

Sa i përket aseteve komunale për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave, Komuna e Shtimes ka, 3,105 kontenjer 5 kamionë dhe 3 traktorë.

Sasia totale e mbeturinave komunale të grumbulluara për vitin 2022, në Komunën e Shtimes ishte 4,486 ton. Brenda një viti gjenerohen 243.85 kg për kokë banori, ose 0.67 kg mbeturina në ditë për kokë banori.

Mbeturinat e grumbulluara nga KRM "Pastërtia", dërgohen për deponim në Deponinë Sanitare në Mirash - Obiliq.

Në vitin 2023 janë evidentuar 24 deponi ilegale të mbeturinave prej të cilave: Deponi e madhe 11, deponi e mesme 7, deponi e vogël 6. Krahasuar me vitin e kaluar kemi rritje të deponive ilegale megjithëse 2 deponi të mëdha janë eliminuar në këtë vit.

Sa i përket riciklimit Komuna e Shtimes ende nuk ka arritur të realizojë ndonjë program të organizuar në tërë territorin e Komunës. Nuk ka ende as programe për ndarjen e mbeturinave në burim, sikurse që nuk ka as iniciativë për kompostimin e mbeturinave organike.

Problematikë tjetër e ngritur nga qytetarët është edhe pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në qytezën e Shtimes. Përveç se nuk ka një mirëmbajtje të mirë edhe për kundër kontraktimit të kompanisë publike "Pastërtia", qytetarët ankohen se disa pjesë të qytezës, lagje dhe rrugë kryesore nuk pastrohen fare¹⁵. Po ashtu edhe problemi i mbeturinave inerte nuk ka marrë ende asnjë zgjidhje. Problem në vehte dhe shumë i rëndësishëm mbetet mos finalizimi i impjatit të ujërave të zeza - Ndërtimi i kolektorëve të ujërave të zeza nga: Carraleva deri në Shtime, Mollopolci deri në Shtime dhe nga Shtimja deri në Vojnovc

¹⁴ Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Shtimes, 2018

¹⁵ Komuna Jonë, Raport i monitorimit të Komunës së Shtimes, Organizata Polis, 2017

5.2 Përkufizimi i problemit

Gjatë përshkrimit të sfondit për secilin nënsektor është bërë një përkufizim i problemit. Përkufizimi i problemit është hartuar nga grupi punues së bashku me ekspertët të jashtëm si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, dmth janë konsultuar aktorët e ndryshëm për grumbullimin e të dhënave, analizën si dhe mbi rezultatet e analizës. Konsultimi i gjerë ka lejuar që problemet të ngrihen "në terren" dhe që zgjidhjet e politikave të përpilohen në bazë të problemeve të indentifikuar por edhe investimet duhet të jenë të tilla. Në lidhje me përkufizimin e problemeve një përmbledhje do të jetë në vijim të tekstit, të cilat do të shërbejnë edhe për identifikimin e projekteve, plotësimin e objektivave specifike, strategjike dhe qëllimin.

Probleme tjera që janë identifikuar gjatë diskutimeve dhe analizës: Kushtet jo të përshtatshme në disa objektet shkollore, mungesa e digjitalizimit, mungesa e hapësirave të nevojshme për fëmijët parashkollor, infrastruktura sportive, mundesa e hapësirës për nxënës në vet vendbanimit e Shtimes.

Problemët kryesore në lidhje me transportin publik janë mungesa e stacioneve të autobusave në gjithë komunën e Shtimes, në vet vendbanimin dhe fshatrat për reth të cilat janë të banuara.

Problemët me të cilat ballafaqohet komuna e Shtimes në sektotin e shëndetësis dhe mirëqenjes sociale janë: mungesa e hapësirës e cila kërkohet sipas standardeve për funksionimin e QKMF, mungesa e pasisjeve teknologjike në shëndetësi, renovimi i QMF, renovimi QPS e tjera.

Problemët që janë definuar gjatë hartimit të kësaj strategjie në lidhje me kulturën, sportin dhe rininë janë: vazhdimi i identifikimit të objekteve tjera kulturore, trashëgimore, renovimi i tyre, mungesa e menaxhimit, mirëmbajtjes së tyre, investime të reja në infrastrukturë sportive, etj.

Problemët që janë identifikuar në infrastrukturë ku janë përfshirë në këtë tabelë janë të shumta dhe kërkesa për investime duke filluar me investime të reja dhe renovime, është shumë e lartë dhe se këto investime gjatë përpilimit të strategjise, janë hasur edhe në kornizën afatmesme buxhetore dhe në vet planifikimet e strategjisë.

Ekonomia ende ballafaqohet me disa probleme të cilat duhet të zgjidhen, toka ku është i vendosur ky park teknologjik i takon klasit të IV dhe sipas ligjeve në fuqi nuk lejohet për shëndërimin në park teknologjik, por së shpejti kjo qështje do të zgjidhet. Po ashtu rrugët lolake që lidhen me këtë park teknologjik janë të lejueshme vetëm për transport deri në 7 ton. Kështu që duhet të vendoset në ndërtimin e një rrugë e cila lidhë parkun teknologjik me rrugën rrugën magjistrale Shtime - Ferizaj (M-25.3). Problem tjetër i cili ka ndikim krucial në tërheqjen e investitorëve është furnizimi i i investitorëve me energji elektrike por duhet marr në konsiderim se konsumatorëve për fshatrat dhe qytezën e Shtimes realizohet realizohet nëpërmjet nënstacionit 35/10 kv Shtimia me fuqi të instaluar prej 2x8 MVA, kurse ka një memorandum për investime me

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës në ndërtimin e një NS me kapacitet 110/35/10(20) me fuqi 2x31.5+40 MV.

Problemet që ballafaqohet sektori bujqesisë janë: fragmetimi tokave, mungesa e investimeve në hapjen e rrugëve fushore, kanaleve të kullimit, legjislacioni në nivel vendi që kërkon që objektet e fermave blegtorale të vendosen 500 metra nga vendanimi, zona e Gllavicës të ketë një pjesë të ndarë vetëm për zhvillime në bujqësi ndaras nga industrit tjera, mungesa e shoqatave dhe kooperativave.

Problemet kryesore në turizëm janë se ende nuk ka filluar zbatimi i asaj strategji dhe se mungojnë investimet.

Problemet kryesore në lidhje me menaxhimin e resurseve ujore janë: Shkarkimi i ujërave të zeza në lumenjë pa trajtim paraprak, degradimi i shtretërve të lumenjëve dhe mbrojtja jo efikase e rrjedhave dhe burimeve ujore.

Problemet të cilat janë identifikuar: cilësia jo e mirë e ajrit në zonat urbane; mungese e inventarit të ndotësve të ajrit; mungesa e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit; mungesa e Planit Lokal për Mbrojtje nga Zhurma dhe furrat e gëlqerës dhe gurëthyesit janë burim i emetimit të ndotësve në ajër.

Në lidhje me menaxhimin e mbeturinave janë identifikuar një mori problemesh: deponitë ilegale të mbeturinave paraqesin ende një ndër problemet kryesore në sektorin e mbeturinave, ende ska programe për ndarjen e mbeturinave në burim, sikurse që nuk ka as iniciativa për kompostimin e mbeturinave organike. Po ashtu edhe problemi i mbeturinave inerte nuk ka marr ende asnjë zgjidhje.

Problem në vehte dhe shumë i rëndësishëm mbetet mos finalizimi i impjatit të ujërave të zeza - Ndërtimi i kolektorëve të ujërave të zeza nga: Carraleva deri në Shtime, Mollopolci deri në Shtime dhe nga Shtimja deri në Vojnovc

Krahasimi me vendet/komunat të tjera – Gjatë hartimit të kësaj strategjie janë krahasuar strategjitë me komunat siq janë Klina, Podujeva dhe Rahoveci në aspektin e zhvillimit ekonomik lokal. Janë konsultuar strategjitë e tyre dhe grupi punues duke bërë një analizë ka gjetur ngjajshmëri të probleme me komunat e lartëpërmendura dhe se çfare zgjidhje kanë ofruar ato komuna në zgjidhjen e atyre sfidave, në lidhje me arsimin, turizmin, bujqësinë, shendetësin. Po ashtu është krahasuar shporta e projekteve.

6. QEVERISJA KOMUNALE


Në këtë kapitull përmbledhet të dhënat:

- struktura dhe organogrami i administratës komunale;
- struktura dhe përbërja e komisioneve të Kuvendit Komunal;
- të ardhurat dhe shpenzimet komunale, para hartimit të SZHEL-së;

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

- tregues të tjerë të menaxhimit në Komunë (projekte dhe bashkëpunime me donatorë që janë në proces).

6.1 Struktura dhe organogrami i administratës komunale



Siq shifet në organogramin e komunës së Shtimes këto janë drejtoritë::

- Drejtoria për administratë të përgjithshme
- Drejtoria për zhvillim ekonomik
- Drejtoria për planifikim urban kadaster, gjeodezi
- Drejtoria për arsim
- Drejtoria e shërbimeve publike
- Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies social
- Drejtoria për kulturë, rinë dhe sport

6.2 Struktura dhe përbërja e komisioneve të Kuvendit Komunal

Janë si në vijim:

- Komiteti për ambient, shërbime publike dhe urbanizëm;
- Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport;
- Komiteti për komunitete
- Komiteti për politikë dhe financa
- Komiteti për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

6.3 Të ardhurat dhe shpenzimet komunale, para hartimit të SZHEL-së

Buxheti Komunal¹⁶ sigurohet prej dy burimeve: grantet nga qeveria qendrore (GQ) dhe të hyrat vetanake (THV).

Më poshtë janë paraqitur të dhënat për buxhetin shpenzuar të komunës së Shtimes për vitet 2020, 2021 dhe 2022.

Tabela 11 - Vlerësimet e hershme buxhetore 2024-2026

Viti buxhetor	Paga & Mëditje	Mallra & Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione & Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithesëjt
2024	5,604,111	1,133,279	20,000	350,000	2,599,429	9,906,819
2025	5,884,317	1,189,943	231,000	367,500	2,729,400	10,402,160
2026	6,178,532	1,249,440	242,550	385,875	2,865,870	10,922,268

Tabela 12 Projektionet e shpenzimeve buxhetore Komunale 2024 - 2026

KOMUNA – SHTIME	Paga & Mëditje	Mallra & Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione & Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithesëjt
PB (2024)	5,604,111	1,133,279	220,000	350,000	2,599,429	9,906,819
VH (2025)	5,884,317	1,189,943	231,000	367,500	2,729,400	10,402,160
VH (2026)	6,178,532	1,249,440	242,550	385,875	2,865,870	10,922,268

¹⁶ Sektori i financave

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

Tabela 13 - Buxheti i planifikuar për vitin 2024

Tabella 15 – Buxheti i planifikuar për vitin 2024						
%& EUR e shpenzimeve të përgjithshme	Plani Buxhetor (2024)					
KOMUNA – SHTIME	Paga & Mëditje	Mallra & Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencion e & Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithesëjt
Gjithsej vlerësimi i hershëm Buxheti 2024 (%)	56.57%	11.44%	2.22%	3.53%	26.24%	100.00%
Gjithsej shpenzimet buxhetore (EUR)	5,604,111	1,133,279	220,000	350,000	2,599,429	9,906,819

Në lidhje me me tregues tjerë sa i përket investimeve kapitale janë konsideruar edhe si burime të sigurta të investimit edhe investimet kapitale nga buxheti nacional dhe donatorët e shumtë në nivel vendi.

7. ANALIZA E PROBLEMIT DHE MUNDËSIVE PËR ZGJIDHJE

Për analiza e problemit grupi punues dhe eksperti kanë marr për bazë analizën SWOT.

7.1 Vlerësimi i aftësive konkurruese (SWOT)

Një nga veglat për të siguruar besueshmërinë e planeve dhe programeve strategjike për zhvillimin e komunës dhe strategjisë së saj është analiza SWOT. Në përgjithësi, analiza SWOT është analizë e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm. Mjedisi i jashtëm i komunës përfshin analizën e mundësive “O” dhe rreziqeve “T” që dalin nga mjedisi i jashtëm i komunës. Ndërsa, mjedisi i brendshëm përfshin analizën e anëve të forta “S” dhe të dobëta “W” të vetë komunës. Bazuar në rezultatet e analizës SWOT, është e mundur të vlerësohet nëse komuna Shtimes ka përparësi dhe burime të brendshme për të realizuar mundësitë në dispozicion dhe për t’iu ikur rreziqeve, dhe cilat mangësi të brendshme kërkojnë eliminim të shpejtë. Përkitazi me atë që u tha më lart, vlerësimi i përmblendhës i gjendjes së komunës së Shtimës është bërë duke përdorur analizën SWOT.

Në vijim janë prezantuar në matricë përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e dala nga analiza e mësipërme e vlerësimit të gjendjes aktuale në komunën e Shtimës. Rendiija e tyre është bërë krahas informatave të nxjerra sipas rrjedhës së renditjes të pjesëve të analizuara.

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2024-2027

SWOT ANALIZA	
FAKTORET TË BRENDSHËM	
Përparësitë	Dobësitë
